Hapet thirrja për aplikime për studentët PhD në Universitetin e Granadës, në Spanjë, në kuadër të programit Erasmus +, për semestrin e dytë të vitit akademik 2022-2023.

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët PhD të Universitetit të Tiranës në Universitetin e Granadës, në Spanjë, për semestrin e dytë të vitit akademik 2022-2023.

http://www.ugr.university/

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve PhD për studime;

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Doktoraturë;

Kohëzgjatja e bursave:

- 3 muaj;

Fushat e studimit:

https://internacional.ugr.es

https://internacional.ugr.es/pages/perfiles/estudiantes/incoming-erasmus-dimension-internacional?lang=en

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (850 EUR në muaj për studentët);

- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	**Kompensimi**
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni link-ut:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit PhD:

- CV (në gjuhën angleze / spanjolle);

- Kopje e Pasaportës;

- Vërtetim studenti (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose spanjolle);

- Listë notash të nivele të mëparshme të studimit (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose spanjolle);

- Letër motivimi në gjuhën angleze / spanjolle;

- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht /Spanjisht);

Për t'u njohur me gjuhët e huaja që pranohen nga Universiteti i Granadës referohuni linkut:

https://intl.ugr.es/docs/KA107/KA107_proySEPIE/KA107_proySEPIE_2019-1-ES01-KA107-063774_req_lang_en.pdf?1562926920

- Research plan, sipas linkut:

https://internacional.ugr.es/pages/perfiles/estudiantes/documentos-incoming-ka107/01modeloplandetrabajoypreadmision

- Letër pranimi paraprake;

https://internacional.ugr.es/pages/perfiles/estudiantes/documentos-incoming-ka107/03preadmisioneng

Afati për aplikim: **28 Mars 2023.**

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!